

Infeksioni juaj	Pa antibiotikë, shumica përmirësohet pas	Si të kujdeseni për veten dhe familjen tuaj	Kur duhet të merrni ndihmë
-----------------	--	---	----------------------------

<input type="checkbox"/> Infeksionet e veshit të mesëm	8 ditë	<ul style="list-style-type: none"> Pushoni mirë. Pini lëngje të mjaftueshme për të shmangur etjen. Pyesni farmacistin tuaj që t'ju rekomandojë mjekime për t'ju ndihmuar me simptomat apo dhimbjen (ose të dyja). Temperatura është një shenjë se trupi po e lufton infeksionin dhe zakonisht përmirësohet vetë në shumicën e rasteve. Mund të përdorni paracetamol nëse ju ose fëmija nuk ndiheni rehat si pasojë e temperaturës. Përdorni një shami letre dhe lani duart mirë për të ndihmuar në parandalimin e përhapjes së infeksionit tuaj te familja juaj, miqtë dhe të tjerët që ju takoni. Gjëra të tjera që mund të bëni të sugjeruara nga mjeku ose infermierja: 	<p>Më poshtë janë shenjat e mundshme të sëmundjes së rëndë dhe duhet të vlerësohen urgjentisht.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nëse lëkura juaj është shumë e ftohtë ose ka një ngjyrë të çuditshme, ose ju dalin urtikarie të pazakonta. 2. Nëse ndiheni të turbullt ose e folura është e paqartë ose jeni shumë të përgjumur. 3. Nëse keni vështirësi në frymëmarrje. Shenjat mund të përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> frymëmarrje të shpejtë nxirrje rreth buzëve dhe e lëkurës poshtë gojës Lëkura ndërmjet dhe sipër brinjëve thithet ose tërhiqet brenda me çdo frymëmarrje. 4. Nëse keni dhimbje të forta koke dhe të vjella. 5. Nëse keni dhimbje në kraharor. 6. Nëse keni vështirësi në të gëlltitur ose ju dalin jargë. 7. Nëse kur kolliteni ju del gjak. 8. Nëse ndiheni shumë më keq. <p>Nëse ju apo fëmija juaj ka ndonjë nga këto simptoma, jeni duke u përkeqësuar ose jeni më të sëmurë se sa prisni (edhe nëse bie temperatura juaj/e tyre), besoni instinktet tuaja dhe kërkoni urgjentisht këshilla mjekësore nga NHS 111 ose mjeku juaj i përgjithshëm. Nëse një fëmijë nën moshën 5 vjeç ka ndonjë nga simptomat 1-3 shkoni tek A&E (Urgjenca) menjëherë ose telefononi 999.</p> <p>Shenja më pak serioze që zakonisht mund të presin deri në takimin e ardhshëm të mundshëm me mjekun e përgjithshëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 9. Në rast se nuk keni përmirësime pas afateve të dhëna në kolonën me titull "Në shumë raste, përmirësohet pas". 10. Te fëmijët me infeksion të veshit të mesëm: nëse del lëng nga veshët e tyre ose nëse kanë shurdhim të ri. 11. Megjithatë, efektet anësore të lehta si diarre, kërkojnë kujdes mjekësor nëse jeni të shqetësuar. 12. Të tjera
<input type="checkbox"/> Dhimbje fyti	7-8 ditë		
<input type="checkbox"/> Sinoziti e	14 - 21 ditë		
<input type="checkbox"/> Ftohje e zakonshme	14 ditë		
<input type="checkbox"/> Kolla ose bronkiti	21 ditë		
<input type="checkbox"/> Infeksion tjetër:ditëditë		

Nëse mendoni se mund të keni COVID-19, atëherë ju lutemi vizitoni seksionin e koronavirusit të GOV.UK dhe NHS për udhëzimet dhe informacionet më të fundit.

Receta rezervë për antibiotikë duhet marrë pas disa ditësh vetëm nëse nuk ndiheni më mirë ose ndiheni më keq.

Të merret nga: Farmacia Mjekët Familjarë Mjeku Familjar, infermierja, tjetër

- Ftohjet, shumica e kollave, sinoziti, infeksionet e veshit, dhimbjet e fytit dhe infeksionet e tjera shpesh përmirësohen pa antibiotikë, pasi trupi juaj mund t'i luftojë zakonisht vetë këto infeksione.
- Marrja e antibiotikëve inkurajon bakteret që jetojnë brenda jush të bëhen rezistente. Kjo do të thotë që antibiotikët mund të mos funksionojnë kur ju keni nevojë për to.
- Antibiotikët mund të shkaktojnë efekte anësore siç janë puçrrat, myku, dhimbje stomaku, diarre, reaksionet ndaj dritës së diellit, simptoma të tjera, ose të vjella, nëse pini alkool me metronidazole.
- Mësoni më shumë për mënyrën se si mund të përdorni më mirë antibiotikët dhe ndihmoni për ta mbajtur këtë trajtim jetik duke vizituar www.nhs.co.uk/keepantibioticsworking.

Mos ia jepni askujt tjetër antibiotikët tuaj dhe kthejini gjithnjë te një farmaci antibiotikët e papërdorur, që të asgjësohen në mënyrë të sigurt.